



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.1.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË ZYRËS SË
KRYEMINISTRIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Kryeministrit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha (Udhëheqës Ekipi) dhe Refiqe Morina (Anëtare), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Arvita Zyferi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	28
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	29
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	32
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	36

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore i Zyrës së kryeministrit (ZKM) për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 21/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i ZKM-së.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vertetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes


Nga kategoria e investimeve kapitale ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht 2,299,007€, për projekte të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, si dhe subvencione, si dhe mungonin dëshmitë për arsyetimin e shpenzimeve nga kategoria e subvencioneve në vlerë 127,450€.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Menaxhmentit të ZKM-së - auditimi 2016**

Menaxhmentit të ZKM-së ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV, të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e ZKM-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se një pjesë e shpenzimeve janë buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht në kategoritë joadekuate, si dhe mungonin dëshmitë për arsyetimin e shpenzimeve të dhëna nga subvencionet, si:

- Furnizimet e ndryshme për projektet² në Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), të cilat sipas UA 2005/08 i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, si dhe subvencione ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Vlera e këtyre pagesave ishte 2,299,007€. Keq klasifikimi i shpenzimeve është rezultat i mos ndarjes së buxhetit në kategorinë përkatëse ekonomike nga ana e MF-së, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme nga AUV-i që buxheti i planifikuar për këto projekte të ndahet nga kategoria mallra dhe shërbime dhe subvencione. Kjo gjendje është shpalosur edhe në PVF-të e ZKM-së; dhe
- Në 25 raste në vlerë 127,450€, përfituesit e subvencioneve të dhëna nga ZKM, nuk ju kishin përmbajtur marrëveshjeve për raportim pas përfundimit të projekti. Ata nuk kishin ofruar dëshmi (fatura, raporte, dhe dëshmi tjera) për të arsyetuar se mjetet e dhëna janë shpenzuar për qëllimin e paracaktuar. Meqenëse, përfituesit e subvencioneve nuk kishin ofruar dëshmi sa i përket shfrytëzimit të mjeteve dhe vlera e tyre ishte materiale ne nuk kemi mundur të marrim siguri lidhur me shfrytëzimin e tyre.

Opinionin ynë nuk është i modifikuar lidhur me çështjet e lartpërmendura.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

ZKA është përgjegjëse për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

² Projektet për: "Sigurinë e ushqimit", "Mbrojtja e shëndetit të kafshëve", "Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve", "Parandalimi dhe trajtimi i etheve hemorragjike" si dhe projekte tjera të ngjashme.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

ZKM-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013 për shpenzimin i parave publike;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore, përfshirë pasqyrat financiare nëntëmujore;
- Raportet për Obligimet e papaguara;
- Plani fillestar dhe final i prokurimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF mund të konsiderohet e saktë, ndonëse ekzistojnë gabime që nuk kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipërpërmendur të baza për opinion si theksim i çështjes, ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat e Agjencive duhet të sigurojnë se kanë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në Theksimin e Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të arsyetuar shpenzimet e dhëna për subvencione për tu siguruar se mjetet janë shpenzuar për qëllimet e dhëna, si dhe të vazhdojë përpjekjet përmes kërkesave në MF që mjetet të buxhetohen sipas kategorisë përkatëse.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ZKM-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga ZKM siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në ZKM lidhur me obligimet statutores dhe cilësinë e raportimit menaxherial pasqyron situatë progresive. Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen me tutje, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të tyre.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i jashtëm është i ulët. Pyetësi i vet-vlerësimit është plotësuar, mirëpo në disa raste nuk mbështetën me dokumentacion përkatës. Për më tepër regjistrat e rreziqeve të hartuar nga menaxhmenti nuk kanë mbuluar të gjitha aktivitetet, e në disa agjenci ekzekutive të ZKM-së nuk ishin hartuar regjistrat e rreziqeve gjatë vitit 2016.

Derisa NjAB kishte kryer disa raporte të auditimit, të cilat ishin të një cilësie të mirë, mirëpo rekomandimet e tyre nuk janë zbatuar sa duhet nga menaxhmenti.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të ZKM-së ka rezultuar me 17 rekomandime kryesore. ZKM-ja kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, tri (3) rekomandime janë zbatuar, tetë (8) janë në proces të zbatimit, ndërsa gjashtë (6) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Rekomandimet e vitit paraprak nuk janë zbatuar plotësisht, ngase ZKM nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP). Andaj, në këtë raport të auditimit përsëri janë ngritur çështjet për përmirësim të aktiviteteve të caktuara. |
| Rreziku | Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e kontrolleve të brendshme në sistemet kryesore financiare dhe menaxheriale, dhe si rezultat kemi përsëritjen e mangësive të njëjta nga viti në vit. |
| Rekomandimi 2 | Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se do ndërmerren veprime shtesë me qëllim të zbatimit të plotë të rekomandimeve të AP-së sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme dhe aty ku rekomandimet janë përsëritur. Një monitorim sistematik nga ana e menaxhmentit është i nevojshëm për të siguruar zbatim efektiv të rekomandimeve dhe brenda afateve të përcaktuara. |

2.2 Pyetësoni i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetëson të vet-vlerësimit për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për auditimin e ZKM-së, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për ZKM-në dhe Agjencitë vartëse më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Pyetësoni i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Bazuar në këtë kemi gjetur se:

- Sipas udhëzimeve të përcaktuara me procedurat e MFK-së dhe rregullës 01/2010, të gjitha organizatat buxhetore duhet të hartojnë një regjistër të rreziqeve. Megjithatë, edhe pse regjistri i rreziqeve është hartuar nga ZKM, ai nuk i mbulon të gjitha aktivitetet. Po ashtu ky regjistër nuk kishte ndonjë përshkrim të rreziqeve të pritshme kundrejt objektivave si dhe veprimeve të nevojshme për menaxhimin e tyre. Po ashtu Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK)³ dhe AUV ishin në proces të identifikimit të rreziqeve të mundshme kundrejt objektivave, ndërsa Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) nuk kishte vendosur ende ndonjë procedurë për menaxhimin e rreziqeve; dhe
- Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) nuk konsiderohen plotësisht të vendosura nga ZKM-ja, pasi që AUV-i dhe ASHAK-u ende nuk kishin të aprovuar strategjinë.

Rreziku Mungesa e strategjisë së përgjithshme dobëson proceset strategjike dhe operative, si dhe pamundëson hartimin e planit për menaxhimin e rreziqeve. Kjo mund të ndikojë edhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 3 Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat e Agjencive duhet të aplikojnë një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime për adresimin e fushave me dobësi të identifikuara në pyetësorin e vet-vlerësimit.

³ ASHAK, prej vitit 2017 ka kaluar në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinise dhe Sporteve.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ZKM operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

ZKM ka një numër të Agjencive Ekzekutive⁴, PFV-të të cilave janë konsoliduar me PFV-të e ZKM-së. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportim me kohë.

Çështja 4 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i mesëm

E gjetura

ZKM është përgjegjëse për të gjitha aktivitetet financiare dhe menaxheriale të agjencive vartëse të saj. Raportimi i brendshëm dhe linjat e llogaridhënies ndërmjet ZKM-së dhe agjencive ekzekutive, vazhdojnë të mbeten edhe me tutje sfidë. Krye shëfat Ekzekutiv të Agjencive raportojnë tek Kryeministri apo Zëvendës Kryeministri përkatës, derisa Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për pasqyrat e konsoliduara financiare. Për qëllime të konsolidimit të informatave dhe raporteve financiare, Agjencitë dërgojnë raporte në departamentin e financave në ZKM mirëpo ato shpesh janë të mangëta dhe të cilësisë së dobët. Po ashtu Menaxherët e departamenteve brenda ZKM-së dorëzojnë raporte javore tek Sekretari i Përgjithshëm.

Megjithatë, pavarësisht se linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin funksionale përmes takimeve të rregullta dhe raportimit me shkrim, në disa fusha kontrollet e brendshme nuk janë aplikuar në mënyrë efektive dhe nuk kanë arritur t'i parandalojnë gabimet gjatë vitit. Me theks të veçantë, kontrollet ishin jo efektive në fushën e subvencioneve, shpenzimeve përmes prokurimit, menaxhimit të pasurisë si dhe në raportimin e obligimeve të papaguara.

⁴ Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK), Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), Sekretariati i Këshillit të Sigurisë i Kosovës (SKSK) dhe Agjencia e Kosovës për mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRSB).

Rreziku Linjat e papërshtatshme të llogaridhënies ndërmjet ZKM-së dhe Agjencive vartëse të saj si dhe mos aplikimi i kontrolleve brenda ZKM-së kanë reduktuar efektivitetin e menaxhimit financiar brenda ZKM-së. Kjo rezulton në dobësi në procesin e shpenzimeve dhe aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi 4 Sekretari i Përgjithshëm duhet ta bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave për raportim të vendosura mbi Agjencitë, në mënyrë që të përcaktohen rregulla të qarta të raportimit formal rreth aktiviteteve operative dhe financiare, për të mbështetur menaxhimin efektiv të proceseve dhe aktiviteteve të ZKM-së.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy (2) auditor. Njeri prej tyre është i strukturuar në kuadër të ZKM-së dhe mbulon auditimin e aktiviteteve të ZKM-së, ndërsa auditori tjetër është në kuadër të AUV-it.

NjAB në përputhje me planin strategjik kishte përgatitur planin vjetor për vitin 2016, ku kishte planifikuar dhe realizuar katër (4) auditime. Megjithatë, cilësia e raporteve të realizuara nga NjAB-i ishte mjaft e mirë ku ishin dhënë rekomandime të dobishme për përmirësimin e kontrolleve të brendshme.

Po ashtu edhe Komiteti i Auditimit (KA) ishte efektiv duke mbajtur takime të rregullta gjatë vitit 2016. Në ato takime ishin diskutuar çështjet e paraqitura në raportin e auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015 si dhe çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm.

Çështja 5 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-it – Prioriteti i lartë

E gjetura Në raportet e auditimit të brendshëm ishin dhënë rekomandime mjaft të dobishme, zbatimi i të cilave do të ndikonte në përmirësimin e kontrolleve të brendshme. Menaxhmenti i ZKM-së dhe Kryeshefat e Agjencive kishin përgatitur plane për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm, mirëpo nuk kishin ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre. Si pasojë, përkundër rekomandimeve nga NJAB-i mangësi të njëjta janë duke u përsëritur nga viti në vit në disa fusha kyçe të MFK-së.

Rreziku Moszbatimi i plotë i rekomandimeve të NJAB-it, zvogëlon cilësinë e menaxhimit financiar dhe ndikon në mos përmirësimin e kontrolleve të brendshme duke shkaktuar përsëritjen e mangësive të njëjta vit pas viti.

Rekomandimi 5 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë një bashkëpunim të ngushtë me NjAB-në dhe KA-në për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Megjithatë, kontrollet mbi shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime të theksuara janë: mallrat dhe shërbimet (prokurimi dhe procedimi i pagesave), subvencionet (kriteret e dhënies së subvencioneve dhe monitorimit të tyre, si dhe menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Këto janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	-	-	5,743,595	5,627,251	5,287,972
Donacionet	-	-	1,089,873	299,080	107,500
Totali	-	-	6,833,468	5,926,331	5,395,472

Të hyrat vetjake prej 353,634€ ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e AUV-it dhe ASHAK-ut. Pjesa e mbetur e të hyrave të arkëtuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK). Të hyrat e vitit 2016 krahasuar me vitin 2015 ishin rritur për 907,134€. Rritja ishte kryesisht rezultat i përkrahjes më të madhe të donatorëve.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁵	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	11,801,633	12,913,313	11,557,074	9,848,779	10,090,142
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,447,999	10,991,376	10,517,645	9,303,190	9,418,659
Të bartura nga viti paraprak ⁶ -	-	145,870	62,827	109,837	190,652
Të hyrat vetjake ⁷	353,634	353,634	182,180	187,790	140,831
Donacionet e brendshme	-	19,547	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	1,402,885	794,422	247,962	340,000

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 9.42% apo 1,111,680€. Buxheti final në raport me buxhetin fillestar kishte pësuar ndryshime dhe përshtatje të shumta gjatë vitit 2016. Në njërin anë buxheti ishte rritur si rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme, të hyrave të bartura nga viti paraprak, në total prej 1,568,302€, ndërsa në anën tjetër fondet nga granti qeveritar ishin zvogëluar për 456,622 bazuar në vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2016, ZKM-ja ka përdorur 89.5% të buxhet final ose 11,557,074€, krahasuar me vitin 2015 kishte një rënie të lehtë prej 1.5% të realizimit të buxhetit final. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,801,633	12,913,313	11,557,074	9,848,779	10,090,144
Pagat dhe Mëditjet	4,316,179	4,431,801	4,385,848	4,244,411	3,885,134
Mallrat dhe Shërbimet	3,159,627	3,324,932	2,732,415	2,933,865	2,836,490
Shërbimet komunale	184,133	112,807	110,677	123,965	134,430
Subvencionet dhe Transferet	1,480,000	1,671,428	1,502,811	782,821	1,512,375
Investimet Kapitale	2,661,694	3,372,345	2,825,323	1,763,717	1,721,715

⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁶ Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁷ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Si rezultat i rishikimit buxhetor, donacioneve të bartura nga viti 2015 dhe atyre të vitit 2016 si dhe vendimeve të qeverisë buxheti final për Paga dhe Mëditje në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 115,622€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte afro 99%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 165,305€. Rritja ishte rezultat i rishikimit buxhetor, vendimeve të qeverisë, të hyrave të bartura si dhe granteve të përcaktuara të donatorëve në vlerë prej 403,731€. Pavarësisht rritjes së buxhetit final, niveli i ekzekutimit ishte 82% të buxhetit final;
- Po ashtu buxheti për shpenzime komunale ishte rritur nga granti qeveritar për 7,200€ dhe ishte zvogëluar në njësitë buxhetore të ZKM-së, sipas vendimeve të Qeverisë për kursimeve buxhetore në vlerë prej 78,526€;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 191,428€. Buxheti ishte rritur nga donacionet e pa shpenzuara të vitit 2015 në vlerë prej 133,493€, nga donacionet e pranuar në vitin 2016 në vlerë prej 132,196€ si dhe me vendime të qeverisë në vlerë prej 114,400€. Buxheti është zvogëluar për 188,661€ sipas vendimit të qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 90%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale ishte rritë për 710,651€. Fillimisht, buxheti ishte rritur nga granti qeveritar për 817,400€ (për financimin e projektit "Ndërtimi i fabrikës së riciklimit" me rishikim buxhetit janë ndarë 424,400€, ndërsa me rastin e paraqitjes së sëmundjes LSD, me vendim të Qeverisë 393,000€). Buxheti ishte rritur edhe nga donacionet në vlerë 544,151 (10,365€ nga donacionet e bartura nga vitet paraprake dhe 533,786€ nga donacionet e vitit 2016). Ndërsa, në fund të vitit me vendim të qeverisë për kursime buxhetore, buxheti ishte zvogëluar për 650,899€. Gjatë vitit 2016 janë shpenzuar 2,825,323€ apo afro 84% e buxhetit final.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga ZKM në 2016 ishin 5,743,595€. Pjesa më e madhe e tyre, në vlerë 5,680,331€ janë realizuar nga AUV-i, ndërsa pjesa tjetër janë realizuar nga ASHAK-u, dhe ZKM-ja.

ZKM se bashku me Agjencitë, kishte vendosur kontrolle funksionale në procesin e mbledhjes, regjistrimit dhe raportimit të të hyrave.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë nga ZKM kanë të bëjnë me llogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e punës si dhe legjislacionin e aplikueshëm. Numri i aprovuar i të punësuarve në ZKM së bashku me Agjencitë vartëse ishte 679, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit 2016 ishte 674.

Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari (SIMFK), si dhe prezantimin e tyre në PVF. Kontrollat kanë funksionuar mirë në këtë fushë, megjithatë nevojiten veprime shtesë për të evituar mangësitë në vijim.

Çështja 6 - Lidhja e kontratave për shërbime të veçanta në kundërshtim me ligjin për shërbyes civil - Prioritet i mesëm.

E gjetura Sipas nenit 12 pika 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (LSHV) emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Gjithashtu, kompensimi shtesë i punonjësve, SHC ose zyrtarëve të OB të angazhuara në trupat tjera me akte të Qeverisë së Kosovës është u ndaluar konform nenit 80 të LMFPP.

ASK, në tri (3) raste kishte lidhur marrëveshje për shërbime të veçanta në kohëzgjatje mbi gjashtë muaj pa procedurë rekrutimi.

Po ashtu ASHAK në pesë (5) raste kishte lidhur marrëveshje për shërbime të veçanta pa procedurë rekrutimi, ku në katër (4) prej tyre ishte lidhur marrëveshje me vetë zyrtarët e ASHAK-ut.

Rreziku Lidhja e marrëveshjeve për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit dhe në kohëzgjatje mbi gjashtë (6) muaj kufizon konkurrencën dhe rritë rrezikun që stafi i përzgjedhur të mos ketë aftësitë e nevojshme profesionale për kryerjen e shërbimeve të kontraktuara. Për më tepër kjo ndikon në rritjen e shpenzimeve të paplanifikuara si rezultat i të cilave mund të krijohen vështirësi financiare për arritjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi 6 Sekretari i Përgjithshëm dhe Krye shefat e ASK-së dhe ASHAK-ut duhet të sigurojnë se angazhimi me marrëveshje për shërbime të veçanta bëhet në përputhje me kërkesat e LSHC-së, duke zbatuar një procedurë të thjeshtuar të rekrutimit dhe në kohëzgjatje më të shkurtër se gjashtë (6) muaj. Për më tepër të ndërprehet praktika e angazhimit të zyrtarëve brenda institucionit me marrëveshje të veçanta.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 3,437,739 €. Prej tyre ishin shpenzuar 2,843,093€, ose 83%.

Ne kemi testuar 61 pagesa nga kjo kategori, si dhe 12 procedura prokurimi për të vlerësuar nëse janë respektuar dispozitat e ligjit të prokurimit publik. Edhe pse janë bërë përmirësime në menaxhimin e shpenzimeve dhe aktiviteteve të prokurimit, edhe më tutje mbeten disa mangësi të cilat duhet të adresohen.

Çështja 7 - Mangësi në procedurat e prokurimit - Prioritet i lartë

E gjetura

Auditimi jonë mbi menaxhimin e procedurave të prokurimit ka identifikuar mangësitë në vijim:

- **Tenderët jo normalisht të ulët** - Në rastet kur një operator ekonomik dorëzon një tender jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues (AK) në pajtim me nenin 61 të LPP-së duhet të kërkojë me shkrim nga Operatori Ekonomik (OE) të bëjë një shpjegim për çmimin e ultë. Nëse tenderi pas shpjegimit të dhënë nga OE shihet si jo normalisht i ulët duhet të refuzohet nga AK. Megjithatë në dy (2) raste janë lidhur kontrata publike kornizë me OE të cilët kanë ofruar tender jo normalisht të ulëta pa kërkuar sqarim me shkrim nga OE. Kjo ka ndodhur tek procedurat e prokurimit për "Sigurimin e automjeteve të ZKM-së", vlera e kontratës kornizë 5,343€, si dhe "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të ASK-së", vlera e kontratës kornizë 19,433€. Një numër i madh i çmimeve tek këto dy kontrata ishin ofruar me vetëm 0,10€. Për me tepër në të dy (2) rastet në dosje të tenderit nuk ishin specifikuar sasi të përafërta në lidhje me kontratat për mallra, punë dhe shërbime;
- **Lidhja e kontratës në mungesë të kriterëve të përcaktuara** - Tek aktiviteti i prokurimit "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare të ASHAK-ut", në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë të datës 17.06.2016 ishin vendosur kërkesat për përshtatshmëri teknike dhe profesionale, ku një nga kërkesat ishte sjellja e dëshmimeve për të vërtetuar se servisi është i autorizuar për llojin përkatës të automjeteve. Megjithatë, AK me datën 25.07.2016 kishte lidhur kontratë publike kornizë në vlerë 6,664€ me një OE i cili nuk kishte sjellë dëshmi për të vërtetuar se është servis i autorizuar;

- **Ndarja e kërkesave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratave të shumta për artikuj të njëjtë** - Sipas LPP, kërkesat për prokurim të cilat janë të natyrës së ngjashme apo të ndërlidhura duhet të konsolidohen përmes zbatimit të një procedure të përbashkët të prokurimit, për të fituar vlerën për paranë dhe eliminuar koston e prokurimit. Gjatë rishikimit të listës së kontratave të nënshkruara të ZKM-së kemi vërejtur se për furnizime të natyrës së ngjashme ishin lidhur dy apo më tepër kontrata. Kjo kishte ndodhur kryesisht tek furnizimet me pajisje të TI, furnizimet me flamuj, si dhe tek servisimi i printerëve;
- **Mos respektimi i parimeve për ndarjen e detyrave** - Sipas Rregullave dhe udhëzuesit operativ të prokurimit publik, nenit 62.3 parimet e ndarjes së detyrave, një anëtarë i cili ka përgatitur specifikimet teknike ose ka përcaktuar standardet e cilësisë nuk mund të marrë pjesë si anëtarë i komisionit të vlerësimit. Po ashtu një anëtarë i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet menaxher i projektit. Tek procedura e prokurimit për “Furnizim me parket ekskluziv dhe material përcjellës” për kabinetin e Kryeministrit, zyrtari i njëjtë i cili ka përgatitur specifikimet teknike ishte caktuar anëtarë i komisionit të vlerësimit dhe menaxher i kontratës si dhe ka marrë pjesë në komisionin për pranimin e punimeve, duke mos ndjekur parimet për ndarjen e detyrave; dhe
- **Vazhdimi i kontratës publike kornizë në kundërshtim me LPP** - Sipas nenit 38 të LPP-së, kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet. Megjithatë, kontrata publike kornizë për shërbime të shtypjes, marketingut dhe shërbime tjera e cila kishte skaduar me datën 16/02/2016, ishte vazhduar me datën 17/02/2016 edhe për 3 muaj.

Rreziku

Kontrollet jo efektive në procesin e prokurimit në ZKM rrisin rrezikun për mos arritjen e vlerës për paranë e shpenzuar, duke bërë ndarjen e kërkesave të prokurimit, dhe vazhdimin e kontratave publike kornizë. Po ashtu lidhja e kontratave publike kornizë me çmime jo normalisht të ulëta, si dhe mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në njoftimin për kontratë mund të rezultojë që shërbimet e ofruara nga OE të mos jenë të cilësisë së kërkuar.

Rekomandimi 7

Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat e Agjencive duhet të sigurojnë se kanë shtuar kontrollet mbi proceset e prokurimit në veçanti sa i përket ndarjes së kërkesave të prokurimit, respektimit të kriterëve të dosjes së tenderit, kërkimit të sqarimeve dhe vlerësimit të tyre në rastet e tenderëve jo normalisht të ulët. Më tutje, të sigurohet se nuk do të lejohet vazhdimi i kontratave publike kornizë si dhe do të respektohet parimi i ndarjes së detyrave.

Çështja 8 - Kompensimi shtesë i punonjësve - Prioritet i mesëm

E gjetura

Sipas nenit pika 5 të ligjit nr.05/L-071 për buxhetin e vitit 2016 shpenzimi i parave publike nga kategoria mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve. Po ashtu sipas nenit 80 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nuk lejohet kurrfarë kompensimi shtesë për angazhimet e zyrtarëve brenda orarit të rregullt të punës. ZKM kishte anashkaluar kërkesat ligjore duke kompensuar shtesa për angazhimet gjatë orarit të rregullt të punës, si:

- ASK-ja bazuar vetëm në UA NR.08/2012, gjatë vitit 2016 kishte shpenzuar 25,388€ për kompensimin e punonjësve nga kategoria mallra dhe shërbime për angazhimet shtesë të zyrtarëve brenda orarit të rregullt të punës për disa projekte të financuara nga donatorët. Këto pagesa janë bërë për projektet të cilat ishin vazhdimësi nga viti 2015, ndërsa nuk kishte pagesa për ndonjë projekt të ri gjatë vitit 2016;
- Në dy (2) raste kemi vërejtur që zyrtarë të ZKM-së përveç pagës së rregullt kishin marrë edhe shtesa të rregullta mujore pa bazë ligjore. Këto pagesa ishin kryer nga kategoria mallra dhe shërbime pa ndonjë kontratë apo marrëveshje për shërbime të veçanta. Vlera e këtyre pagesave ishte 7,426€; dhe
- Në një (1) rast tjetër zyrtarja e cila përveç pagës së rregullt kishte marrë edhe shtesa nga kategoria mallra dhe shërbime gjatë tërë vitit 2016, ndërkohë që vetëm 21 ditë pune ishte evidentuar në regjistrat e vijueshmërisë së punës. Kjo është në kundërshtim me nenin 59 të ligjit për shërbyes civil, sipas të cilit nëpunësitë civilë janë të detyruar të jenë të pranishëm në vendin e punës në bazë të kushteve të emërimit.

Rreziku

Kompensimi i punonjësve nga kategoria mallra dhe shërbime për angazhime shtesë brenda orarit të rregullt të punës, si dhe kompensimi i zyrtarëve të cilët nuk janë paraqitur në punë, janë në kundërshtim me legjislacionin dhe ndikojnë në keq menaxhim të buxhetit.

Rekomandimi 8

Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e ASK-së duhet të sigurojë se do të respektohen dispozitat e LMFPP dhe nuk do lejohet kurrfarë kompensimi shtesë i punonjësve për angazhimet brenda orarit të rregullt të punës dhe se kompensimi i punëtorëve bëhet vetëm nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.

Çështja 9 - PAGESA PËR FURNIZIM ME BILETA PA DËSHMI TË MJAFTUESHME - PRIORITY I MESËM

E gjetura Sipas nenit 3, pika 2, e kontratës për furnizim me bileta aeroplani, e nënshkruar me datën 29.01.2015, furnizuesi obligohet që çdo fature t'i bashkëngjisë kopjen fizike të rezervimit të biletës nga sistemi AMADEUS apo ndonjë sistem tjetër. Po ashtu sipas këtij neni, pika 3, në çdo biletë të rezervuar furnizuesi obligohet të aplikojë zbritjen prej 6%.

Ne kemi testuar nëntë (9) pagesa për furnizim me bileta në vlerë prej 19,947€, në të cilat kemi vërejtur se nuk kishte dëshmi të mjaftueshme sa i përket çmimit të biletave në datën e rezervimit. Në pesë (5) raste kopjet fizike të rezervimit të biletës nga sistemi AMADEUS nuk përmbanin ndonjë datë të caktuar. Ndërsa në katër (4) raste datat në kopjen fizike të rezervimit nuk përputheshin me datën e rezervimit të cekur në faturë. Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve jo të mira nga ZKM.

Rreziku Aprovimi i shpenzimeve për furnizim me bileta pa siguruar dëshmi të mjaftueshme rritë rrezikun që çmimet në faturë të jenë më të larta se çmimet e biletave në datën e rezervimit duke rezultuar me dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi 9 Sekretari i Përgjithshëm duhet të shtojë kontrollin për t'u siguruar se aprovimi i shpenzimeve për furnizim me bileta bëhet vetëm pas sigurimit të dëshmive të mjaftueshme të cilat do të mundësonin verifikimin e çmimit të biletave nëse janë në përputhje me kontratën.

Çështja 10 - VONESA NË MBYLLJEN E AVANSEVE - PRIORITY I MESËM

E gjetura Sipas UA 2004/07, për udhëtime zyrtare dhe rregullës 01-2013, avanset për udhëtime zyrtare duhet të mbyllen dhe shumat e pa shpenzuara duhet të kthehen në llogarinë bankare brenda dy javësh pas kthimit nga udhëtimi. Ne kemi vërejtur se 28 avanse për udhëtime zyrtare në vlerë 131,170€ nuk ishin mbyllur dhe arsyetuar brenda afatit kohor ligjor.

Rreziku Kontrollat jo efektive në proceset e mbylljes së avanseve për udhëtime zyrtare brenda afatit kohor ligjor rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve, ose mundësisë për shfrytëzimin e tyre për qëllimet tjera private.

Rekomandimi 10 Sekretari i Përgjithshëm duhet të ngrisë nivelin e llogaridhënies dhe përgjegjësisë tek zyrtarët përgjegjës duke kërkuar që dëshmitë për arsyetimin e shpenzimeve të udhëtimit të ofrohen me kohë dhe procedurat e duhura për mbylljen e avanseve të kryhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Çështja 11 - Kontrollë të dobëta në procesin e pranimin të pasurisë - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullores 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, pranimin e pasurisë jo financiare duhet të bëjë komisioni në përbërje prej së paku tre (3) anëtareve të cilët kanë përgjegjësi të bëjnë verifikimin e karakteristikave të pasurisë së pranuar konform kontratës. Po ashtu, sipas nenit 3, të kontratës për furnizim me pjesë rezervë të TI e nënshkruar me datë 30/11/2015, furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve me rastin e dorëzimit të përkohshëm të furnizimeve.

Megjithatë për shkak të kontrolleve jo efektive, tek kontrata për furnizim me pjesë rezervë të TI-së, pranimi i pasurive jo financiare në vlerë prej 9,000€ ishte bërë pa komision, vetëm nga menaxheri i kontratës. Për më tepër malli ishte pranuar nga ZKM edhe pse furnizuesi nuk kishte dorëzuar certifikatë të origjinës me rastin e furnizimeve.

Rreziku Pranimi i pasurive jo financiare pa komision dhe pa përmbushjen e kërkesave të kontratës rrit rrezikun që sasia, cilësia, lloji dhe vlera e pasurisë së furnizuar të mos jetë në pajtueshmëri me kontratën apo urdhër blerjen.

Rekomandimi 11 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se me rastin e furnizimeve me pasuri jo financiare do të formojë komisionin në përputhje me rregulloren i cili do të bëjë verifikimin e karakteristikave të pasurisë së pranuar në mënyrë që të pranimi i pasurive të jetë në përputhje të plotë me kontratën.

Çështja 12 - Regjistrimi i shpenzimeve në nën kode ekonomike jo adekuate - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas planit kontabël shpenzimet për mëditje të udhëtimit duhet të regjistrohen në kodin 13141. Gjatë vitit 2016 shpenzimet për mëditje të udhëtimit në vlerë 97,689€ janë regjistruan në nën kodin jo adekuat 13140 si shpenzime tjera të udhëtimit zyrtar.

Rreziku Klasifikimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate redukton transparencën dhe ndikon në prezantimin jo të drejtë të shpenzimeve.

Rekomandimi 12 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime shtesë në mënyrë që regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në kode ekonomike përkatëse.

3.1.4 Subvencionet dhe Transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,671,428€. Prej tyre gjatë vitit 2016 ishin shpenzuar 1,502,810€. Pjesa më e madhe e subvencioneve në vlerë 1,342,277€ ishin dhënë me qëllim të mbështetjes së minoriteteve, ndërsa pjesa tjetër në vlerë 160,534€ ishin dhënë për aktivitete për të pagjeturit, si dhe manifestime të ndryshme dhe përkrahje të OJQ-ve.

Kontrollet në këtë fushë janë të dobëta, sidomos sa i përket kriterëve të shpërndarjes së subvencioneve, monitorimit dhe raportimit nga ana e përfituesve të subvencioneve.

Ne kemi testuar gjithsej 49 mostra me vlerë 535,905€, ku kemi vërejtur mangësitë në vijim.

Çështja 13 - Ndarja e subvencioneve pa kriterë të qarta - Prioritet i lartë

E gjetura Rregullorja 01/2013/MF për shpenzimin e parasë publike kërkon që secila organizatë e cila shpenzon mjete për subvencione, të hartojë një rregullore për mënyrën e shpenzimit të mjeteve në këtë kategori.

ZKM ende nuk kishte të aprovuar rregullore për dhënien e subvencioneve, sipas të cilës do të përcaktoheshin kriteret lidhur me dhënien dhe mënyrën e raportimit nga përfituesit. Në mungesë të rregullores, kriteret janë përcaktuar me vendime dhe marrëveshje të përcaktuara. Megjithatë, kriteret nuk ishin të qarta në të gjitha rastet, e posaçërisht nuk përcaktoheshin mënyra e raportimit nga përfituesit.

Rreziku Mungesa e rregullores për subvencione, respektivisht mos caktimi i kriterëve të qarta për mënyrën e raportimit nga përfituesit, rritë rrezikun që mjetet e dhëna të mos arrijnë qëllimin e duhur.

Rekomandimi 13 Sekretari i Përgjithshëm të sigurojë hartimin dhe aprovimin e një rregulloreje, e cila do të përcaktonte kriteret e përzgjedhjes, si dhe mënyrën e raportimit nga përfituesit për t'u siguruar se subvencioni ka arritur qëllimin për të cilin është dhënë.

Çështja 14 - Dobësi në shpërndarjen e subvencioneve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas nenit 5 të vendimit për miratimin e programit për komunitete, OJQ-të që aplikojnë në ftesën për propozime të shpallura nga Zyra për Çështje të Komuniteteve (më tutje ZÇK) duhet të plotësojnë disa kritere, ku njëra ndër to është që të jenë të regjistruara në organin kompetent në Republikën e Kosovës.

ZÇK në një rast kishte subvencionuar një biznes në vlerë 4,500€ në komunën e Leposaviqit, i cili fare nuk ishte i regjistruar në organet kompetente të Republikës së Kosovës. Kjo është në kundërshtim me programin e aprovuar për komunitete. Po ashtu përfituesi nuk kishte ofruar ndonjë dëshmi për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve.

Rreziku Shpërndarja e subvencioneve në kundërshtim me programin e aprovuar për komunitete rrit rrezikun që mjetet të keqpërdoren për qëllime tjera.

Rekomandimi 14 Sekretari i Përgjithshëm nëpërmjet të ZÇK-së duhet të sigurojë se dhënia e subvencioneve bëhet në përputhje me programin e aprovuar për komunitete.

Çështja 15 - Mos respektim i marrëveshjeve të përcaktuara dhe keq klasifikim i shpenzimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet Zyrës së Kryeministrit respektivisht ZÇK-së dhe komunës së Vitisë të datës 26/05/2016 në vlerë 40,000€, për financimin e projektit për rregullimin e një shëtitoreje, ZÇK-ja emëron një përfaqësues për mbikëqyrjen e realizimit të projektit, si dhe një përfaqësues në komisionin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave, me rastin e zhvillimit të procedurave të prokurimit, i cili ishte mbuluar nga Komuna e Vitisë.

ZÇK-ja nuk kishte emëruar ndonjë përfaqësues për mbikëqyrje të projektit e as në komisionin e hapjes dhe vlerësimit siç parashihet me marrëveshje dhe si rrjedhojë e gjithë procedura ishte mbikëqyrur vetëm nga përfaqësuesit e komunës.

Për me tepër, pagesa për financimin e projektit të sipërpërmendur në vlerë 30,400€ është regjistruar në kodin ekonomik jo adekuat 21200 - subvencione për entitete jo publike, ndërsa është dashur të regjistrohet në kodin ekonomik 33100 - transfere kapitale për entitete publike.

Rreziku Mos pjesëmarrja e përfaqësuesve të ZKM-së në komisionin përkatës siç parashihet me marrëveshje rrit rrezikun që të ketë devijime nga projekti për të cilin janë ndarë mjetet. Derisa, klasifikimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate redukton transparencën dhe ndikon në prezantimin jo të drejtë të shpenzimeve

Rekomandimi 15 Sekretari i Përgjithshëm nëpërmjet ZÇK-së duhet të sigurojë se janë plotësuar kushtet e marrëveshjes që kanë të bëjnë me caktimin e përfaqësuesve të ZKM-së në komisionet përkatëse. Më tutje, të sigurojë se janë ndërmarrë veprime shtesë në mënyrë që regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në kode ekonomike përkatëse.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,372,345€. Gjatë vitit 2016 ishin shpenzuar 2,825,323€, prej të cilave 2,299,007€ ishin shpenzuar për projekte të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.

Kontrollet në këtë fushë kanë funksionuar mirë me përjashtim të keq klasifikimit të shpenzimeve për shkak të buxhetimit joadekuat nga ana e Ministrisë së Financave, e cila është prezantuar të theksimi i çështjes të opinionit të auditimit.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1,000€) ishte 4,673,885€, vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) ishte 267,450€, si dhe vlera e stoqeve ishte 101,163€.

Auditimi jonë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi çështjet në vijim:

Çështja 16 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i mesëm

E gjetura ZKM se bashku me Agjencitë vartëse të saj nuk kishte arritur të menaxhojë pasuritë e saj në përputhje me rregulloren për menaxhimin e pasurisë, si:

- Inventarizimi i pasurisë ishte kryer në përputhje me rregullën e thesarit 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, megjithatë në AUV dhe ASHAK nuk ishte bërë harmonizimi i të dhënave ndërmjet regjistrave të pasurisë dhe raporteve të inventarizimit;
- Toka dhe ndërtesa e ASK-së për shkak të pronësisë së trashëguar ende nuk ishin të vlerësuara dhe regjistruara si pasuri;
- OB-të sipas rregullores 02/2013 duhet të themelojnë një regjistër kontabël, ku përveç informatave të kërkuara nga Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, do të përfshihen edhe këto elemente: numri serik, barkodi dhe elementet tjera. Megjithatë, te AUV, në listat e pasurive jo financiare të e-pasurisë në shtatë (7) raste të mostrave të testuara mungonte numri serik dhe barkodi i pasurisë; dhe

- Vlera e stoqeve të AUV-it dhe ASK-së në sistemin e-pasuria ishte më e ulët sesa vlera e stoqeve të numëruara nga komisioni i vlerësimit. Te AUV diferenca ishte 18,254€, ndërsa tek ASK 4,201€. Kjo gjendje ishte si rezultat i stoqeve të bartura ndër vite të cilat nuk ishin regjistruar në softuerin e-pasuria.

Rreziku Mos azhurnimi i regjistrit të pasurisë, si dhe mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël, rrisin rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi 16 Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të sigurojnë se kanë forcuar kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë e që menaxhimi dhe raportimi i tyre të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore.

Çështja 17 -Mungesa e evidencave të plota për përdorimin e automjeteve - Prioritet i mesëm

E gjetura UA 03/2008 për menaxhimin e automjeteve zyrtare kërkon që për secilin automjet zyrtar të mbahen evidenca lidhur me shfrytëzimin e tyre. Në dosjet e dy (2) automjeteve kemi vërejtur se nuk ishin mbajtur evidenca të rregullta që arsyetojnë shfrytëzimin e tyre, fletë udhëtimet apo dokumentet e nevojshme për regjistrimin e kilometrave dhe shpenzimeve të realizuara siç kërkohet me udhëzim administrativ.

Rreziku Mosrespektimi i procedurave për menaxhimin dhe përdorimin e automjeteve, ndikon në shfrytëzimin jo racional të tyre dhe mund të pasojë me kosto shtesë të karburanteve, si dhe shpenzime tjera rreth riparimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Rekomandimi 17 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë aplikuar kontrolle efektive në menaxhimin e automjeteve për të parandaluar përdorimin e tyre pa evidentimin e arsyeshmërisë, qëllimit, destinimit, kilometrave dhe karburanteve të shpenzuara. Këto kontrolle do të ndikonin në përdorimin e rregullt dhe efikas të automjeteve.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 223,755€. Faturat për detyrimet e papaguara kryesisht i takonin muajit dhjetor 2016 të cilat nuk ishin paguar për shkak të mbylljes së sistemit të pagesave. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2016 ishin zvogëluar dukshëm në krahasim me vitin e kaluar ku detyrimet në fund vit 2015 ishin 601,909€. Megjithatë, vlera e detyrimeve të papaguara mbetet ende e lartë.

Çështja 18 - Vonesat në pagesa si dhe mos raportimi i obligimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave të raportojnë në baza mujore faturat e pranuar dhe të papaguara. Në shtatë (7) raste faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë prej 21,915€ nuk ishin përfshirë në raportet mujore të obligimeve.

Gjithashtu, sipas nenit 39 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, organizata buxhetore duhet çdo faturë të vlefshme ta paguaj brenda afatit kohor prej 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Gjatë testimeve tona kemi vërejtur që në 8 raste faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë 63,042€ ishin paguar pas afatit kohor ligjor.

Rreziku Kontrollat jo të mira në menaxhimin e pagesave dhe raportimin e obligimeve mund të ndikojnë që organizata të hyjë në obligime pa buxhet ose të paguajë ndëshkime mbi vonesat, duke shkaktuar kështu vështirësi buxhetore në fund të vitit.

Rekomandimi 18 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor, si dhe raportimi i obligimeve të papaguara do të bëhet në përputhje me rregulloren 04/2011 për raportimin e obligimeve të papaguara.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat menaxhmenti duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak


Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Pasqyrat financiare	ZKA në bashkëpunim me Drejtorin e Zyrës për Çështje të Komuniteteve duhet të forcojë edhe më tutje kontrollet mbi subvencione duke zbatuar dhe aplikuar kërkesa strikte për dëshmitë që duhet të ofrohen nga përfituesit me rastin e pranimit të mjeteve të subvencionit. Duhet ti jepet konsideratë edhe vendosjes së kërkesës ndaj përfituesve për kthimin e fondeve në rastet ku nuk janë ofruar dëshmi të përshtatshme/duhura.			Nuk është zbatuar.
Implementimi i rekomandimeve	ZKA në bashkëpunim me Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive duhet ta prioritetizojnë implementimin e rekomandimeve të auditimit dhe të sigurohen se një plan veprimi menaxhohet në mënyrë proaktive dhe i cili detajon stafin përgjegjës dhe orarin për implementimin e secilit nga rekomandimet. Implementimi i planit të veprimit duhet të rishikohet nga ZKA në baza mujore.		ZKM ka aprovuar planin për implementimin e rekomandimeve, mirëpo nuk janë ndërmarrë veprime të mjaftueshme për zbatimin e plotë të tyre.	
Lista e vetëvlerësimit	ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të sigurojnë se lista kontrolluese e vet-vlerësimit është kuptuar plotësisht nga i gjithë stafi i përfshirë në plotësimin e tyre dhe të sigurojnë se është aplikuar një rishikim mbikëqyrës para se të dorëzohet në Ministrinë e Financave, për të siguruar se përgjigjet janë të bazuara në dëshmi.		Pyetësorët e vet-vlerësimit ishin plotësuar formalisht, mirëpo në disa raste nuk janë mbështetur me dëshmi relevante siç është rasti tek ASK dhe AUV ku procedurat për menaxhim të rrezikut nuk ishin plotësisht të vendosura.	

Raportimi menaxherial	ZKA duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit ndaj agjencive ekzekutive si dhe të siguroj aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat e vitit 2016.		Është në proces, mirëpo duhet të përmirësohet edhe me tutje ky procesi i raportimit.	
Menaxhimi i rrezikut	ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të sigurojnë se kërkesat për menaxhim të rrezikut janë vlerësuar dhe se përgjegjësia për aspektet kyçe të kësaj është deleguar tek zyrtarët përkatës. Aty ku është e përshtatshme, për stafin përkatës duhet të ofrohet trajnim. Regjistrat e rrezikut dhe veprimet e ndërmarra për lehtësimin e rrezikut të identifikuar duhet të rishikohen nga ZKA në baza periodike.		ZKM ka hartuar regjistrin për menaxhimin e rreziqeve, mirëpo AUV dhe ASHAK nuk kishin hartuar regjistrat, ndërsa ASK nuk kishte vendosur procedura për menaxhimin e rreziqeve.	
Proceset e llogaridhënies	ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të sigurojnë se është kryer një rishikim për të përcaktuar përmbajtjen dhe formën e raportimit që kërkohet për ta mbështetur menaxhimin efektiv të ZKM-ës dhe agjencive vartëse. Dokumentacioni i azhurnuar duhet të përfshijë shënime të detajuara sqaruese të cilat sqarojnë arsyet për të gjitha variancat, përveç atyre të vogla, dhe ofrojnë bazën për rishikimin e arritjeve operative në baza të rregullta (së paku në baza mujore).		Në proces të adresimit, edhe në vitin 2016 janë identifikuar disa mangësi të njëjta.	
Auditimi i brendshëm	ZKA duhet të kërkojë ti zgjidh/prioritizoj çështjet ekzistuese lidhur me personelin shtesë për të mundësuar punësimin e numrit të nevojshëm me auditor të brendshëm. Duhet të bëhet një rishikim i rregullt (të paktën çdo dy muaj) i zbatimit të rekomandimeve të AB-ës dhe KA.		Në kuadër të AUV-it gjatë vitit 2016 ishte punësuar një auditore, mirëpo rekomandimet e NJAB-it nuk janë zbatuar plotësisht.	
Investimet kapitale	ZKA dhe Kryeshefi i AUV-it duhet të insistojnë edhe më tutje në bashkëpunimin me MF-in për të kërkuar zgjidhje për keq klasifikimin material aktual të shpenzimeve. Ky bashkëpunim duhet ti theksoj vlerat relative të cilat paraqesin rrezikun që nga auditori i jashtëm të jep një opinion të modifikuar.			Nuk është zbatuar.

Shpenzimet përmes prokurimit	ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet ti analizojnë arsyet e lëshimeve procedurale të identifikuar të cilat rezultojnë në dobësi sistematike të prokurimit dhe të shtojnë kontrollet për të evituar përsëritjen e tyre në të ardhmen.	Po		
Shpenzimet përmes prokurimit	ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutivë të sigurojnë zbatimin e një rishikimi të brendshëm për të përcaktuar se pse nuk zbatohen kërkesat e prokurimit për të arritur një efekt më të mirë për ZKM. Rrjedhimisht, duhet të prezantohen kontrolle të përmirësuara në mënyrë që të sigurohet se dobësitë jo sistematike të theksuara më lartë janë adresuar dhe nuk janë përsëritur.			Nuk është zbatuar.
Shpenzimet jo përmes prokurimit	ZKA duhet të sigurojë se janë aplikuar kontrolle efektive për të siguruar se të gjitha avancet mbyllen brenda afatit ligjor. Përdoruesi Kryeshefi i ASK-së të sigurojë se të gjithë nëpunësit kompensohen vetëm nga kategoria e paga dhe mëditjeve.			Nuk është zbatuar.
Pagat dhe mëditjet	ZKA dhe Kryeshefi Ekzekutiv duhet të sigurojnë se për pozitën e udhëhequr me ushtrues detyre bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore.	Po		
Subvencionet dhe Transferet	ZKA duhet të sigurojë që draft rregullorja është finalizuar dhe aprovuar me atë nivel të detajeve që ofrojnë qartësi mbi procesin e dhënies dhe të monitorimit dhe me përgjegjësi qartë të caktuara edhe për zyrtarët e entitetit edhe përfituesit, rregullore e cila përcakton objektivat dhe kriteret si dhe mënyrën e raportimit nga përfituesit e subvencioneve. Në këtë mënyrë do të garantohej se subvencioni është përdorur për qëllimin e dhënë.		Ishte aprovuar vendimi i Qeverisë nr. 04/90 datë 01/06/2016 mbi aprovimin e programit për komunitete. Mirëpo nuk ishte hartuar rregullorja për shpërndarjen e subvencioneve ku do të caktoheshin kriteret dhe objektivat për dhënien e subvencioneve.	

Të hyrat	ZKA së bashku me Kryeshefin e AUV-it, duhet të sigurojnë që softueri të funksionalizohet në pajtim me afatet e pritura dhe të mbështetet nga trajnimi adekuat për stafin. Struktura e kodimit ekonomik të rishikohet për të siguruar se i përmbush nevojat biznesore.	Po		
Pasuria	ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet ta vlerësojnë qartë çdo mangësi në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive dhe të marrin në konsideratë se si mund të adresohen këto çështje. Procedurat e përmirësuara dhe një prioritizim i kohës së stafit duhet të zbatohet për të siguruar që e-pasuria është azhurnuar dhe të barazohet me regjistrat e pasurisë.		Toka ku janë ndërtuar objektet e AUV-it ishte regjistruar si pasuri si dhe ABGJ kishte regjistruar pasuritë te e-pasuria. Ndërsa Toka dhe ndërtesa e ASK-së të pronësisë së trashëguar ende nuk ishin vlerësuar dhe regjistruar si pasuri.	
Menaxhimi i automjeteve	ZKA dhe Kryeshefat e agjencive duhet të sigurojnë se janë vendosur kontrole adekuate, që mundësojnë mbikëqyrjen e plotë rreth shfrytëzimit të automjeteve sipas kërkesave të udhëzimit përkatës.			Nuk është zbatuar.
Obligimet	ZKA dhe Kryeshefat e Agjencive duhet të forcojnë mekanizmat e kontrollit në mënyrë që obligimet të paguhen brenda afatit ligjor dhe të regjistrohen saktë dhe raportohen tek MF me kohë.			Nuk është zbatuar.

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin
2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Fitim Krasniqi,.....

Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Kosovës,
Data: 02.06.2017, Prishtinë